



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2020:042561

Datë: 04.12.2024

Numri i dokumentit: 06547834

C.nr.188/2020

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Alba Makolli, me sekretaren juridike Shpresa Hoxha, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, Rr. “...”, p.nr.me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit B. G., kundër të paditurit A.K., nga Fshati ..., Komuna e Kaçanikut, me objekt kontesti rimbursim dëmi, vlera e kontestit 837 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 20.11.2024, ndërsa me datë 04.12.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri A.K. që paditëses t’ia rimbursojë shumën prej 837.00 euro, në emër të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 01.08.2018 në Kaçanik dhe atë me kamatë, sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga dita e ngritjes së kësaj padie e deri në pagesën përfundimtare.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja me datën 06.03.2020 pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi për rimbursim të dëmit material dhe jo material. Në padi ka theksuar se i padituri, ka shkaktuar aksident me datë 01.08.2018 rreth orës 16:55 në Kaçanik, ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin Mercedes me targa të regjistrimit SKA, deri tek aksidenti ka ardhur kur automjeti “A”, të cilin e drejtonte A.K., i cili nga pakujdesia i shkakton dëme të dëmtuarit B.K.. Automjeti i cili ishte shkaktar i këtij aksidenti, në momentin e shkakimit të tij ka qenë pa mbuluese siguruese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit. Si rezultat i këtij aksidenti, të dëmtuarit B.K., Byroja

Kosovare e Sigurimit e ka kompensuar. Paditësja, duke iu referuar dispozitave të Ligjit për Sigurim të Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia nr.04/l-018 neni 18 paragrafi 1, kërkojnë nga gjykata të aprovohet kërkesëpadia e paditësit BKS si e bazuar, të detyrohet i padituri të rimbursojë shumën prej 837.00 euro në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut dhe atë me kamatë sipas mjeteve të deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar duke llogaritur nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare e autorizuar e paditëses ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, meqë është vërtetuar mjaftueshëm përgjegjësia e të paditurës karshi dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 01.08.2018, ku nga ky aksident paditësja nëpërmjet fondit të kompensimit, e ka kompensuar palën e dëmtuar B.K.n. Andaj, i propozojnë gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia si e bazuar dhe i padituri të obligohet për kthimin e borxhit, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës në shumë prej 20 euro në emër të taksës, si dhe 150 euro për ekspertizën e komunikacionit.

I padituri nuk ka paraqitur përgjigje në padi, mirëpo përgjatë seancave gjyqësore e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, me arsyetimin se nuk është fajtor për aksidentin e ndodhur. Ka propozuar, që kërkesëpadia të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: Lista e transfereve të pagesave të BKS e dt. 24.10.2018, ujdi jashtë gjyqësore në mes BKS dhe B.K.t e dt. 12.10.2018, raporti i aksidentit 01.05.2018, raporti i policit hetues me numër të rastit 2018-CFT-447 i datës 01.08.2018 së bashku me skicë, raporti mjekësor për B.K. i dt. 01.08.2018, konfirmimi i sigurimit i datës 31.08.2018, kërkesa për pagimin e dëmit jo material e datës 20.08.2018 nga i autorizuari i B.K.t, vendimi i komisionit të shkallës së dytë i dt. 05.10.2018, vendimi i komisionit të shkallës së parë i dt. 26.09.2018 si dhe ekspertiza e ekspertit të komunikacionit rrugor XH.M. e datës 21.10.2024.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, e refuzoi në tërësi kërkesëpadinë e paditëses dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykim, nga arsytet si në vijim:

Nuk është kontestuese se me datë me datë 01.08.2018, rreth orës 16:55, në Fshatin ..., në Kaçanik, mes automjetit të cilin e drejtonte tani i padituri A.K. dhe këmbësorit B.K., kishte ndodhur një aksident, në atë mënyrë që lëndime kishte pësuar këmbësori B.K..

Nuk është kontestuese, se mes BKS dhe B.K., ishte lidhur një ujudi jashtëgjyqësore, me të cilën palët ishte dakorduar që atëherë të dëmtuarit B., t'i paguhej shuma prej 837.00 euro, shumë e cila përkon me listën e transferove të pagesave të bëra nga BKS, që vërtetohet se kjo e fundit e ka bërë kompensimin e shumës për të cilën ishin dakorduar me ujudi.

Nuk është kontestuese, se automjeti me targa ....., ka pasur polisë valide prej datës 19.09.2014 deri me datë 19.09.2015, e që rrjedhimisht ditën e aksidentit automjeti që drejtonte tani i padituri A.K., nuk ka pasur polisë valide të sigurimit.

Çështje kontestuese mes palëve, në këtë proces kontestimor ka qenë baza juridike e kërkesëpadiës, dhe atë se a është i padituri përgjegjës për shkaktimin e aksidentit.

Për vërtetimin e bazës juridike të kërkesëpadiës, gjykata me propozim të palës paditëse, ka nxjerrë provën me anë të ekspertizës së komunikacionit me ç'rast eksperti i komunikacionit XH.M. me datë 21.10.2024, ka përpiluar ekspertizën. Sipas mendimit të ekspertit në aksidentin e datës 01.08.2018 rreth orës 16:55, në rrugën fshati ..., fshati ..., Kaçanik, veprimet e pjesëmarrësve në komunikacion kanë qenë në atë mënyrë që këmbësori fillon trupimin e rrugës nga ana e djathtë për në anën e majtë shikuar në drejtim të lëvizjes së njësisë A, kurse shoferi i njësisë A këtu i padituri A.K., ishte duke lëvizur nga drejtimi i fshatit ... në drejtim të fshatit ....., këmbësori para fillimit të trupimit të rrugës, nuk është siguruar se ka automjete në afërsi, ku i njëjti goditet nga njësia A me retrovizorin e anës së djathtë. Më tutje, eksperti ka gjetur se shoferi i njësisë A, pra i padituri nuk ka pasur mundësi teknike që ta shmang aksidentin, për shkak se koha e reagimit të shoferit është 1.0 [s], kurse koha e kalimit të këmbësorit nga trotuari e deri tek pika e goditjes është 0.33 [s]. Përkundrajt se i padituri ka lëvizur në rrugë pa i plotësuar kushtet për qarkullim, nuk ka pasur regjistrim në automjet, mundësia e shmangies së aksidentit do të ishte i mundur vetëm nga ana e këmbësorit në këtë rast. Nga ekspertiza vërtetohet se aksidenti i

komunikacionit ka ardhur si rezultat i mos koncentrimit dhe mos kujdesit të këmbësorit, si dhe fillimit të trupimit të rrugës nga ana e këmbësorit në atë mënyrë të pa sigurt dhe pa u bindur se është vërejtur nga ana e shoferit. Përfundimisht, eksperti paraqet se këmbësori ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Rregullat e Trafikut Rrugor, neni 143.1 dhe 143.2, e që deri tek aksidenti ka ardhur nga lëshimi i këmbësorit.

Gjykata ekspertizën e punuar në këtë procedurë kontestimore të datës 21.10.2024, e ka pranuar në tërësi si të besueshme, të njëjtës ia ka falur besimin e plotë meqë ishte profesionale dhe e argumentuar mirë, po ashtu e punuar sipas vëllimit të përcaktuar nga kjo gjykatë. E njëjta ishte në harmoni me provat tjera që ishin në shkresat e lëndës, gjithashtu edhe eksperti në seancë arriti ta argumentoj të njëjtën.

Në bazë të nenit 136 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”*, ndërsa me nenin 159 të po këtij ligji është paraparë se *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit.”*

Në kuptim të nenit 18 par. 1 të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia përcaktohet se: *Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësise, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja. Kurse në paragrafin 4 të nenit 18 të të njëjtit ligj parashihet se: “Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat.”*

Me aplikimin e kësaj norme ligjore, paditësja ka të drejtë të kërkojë regres nga personi që mbahet përgjegjës për shkaktimin e dëmit, i cili nuk ka pasur mbulesë siguroese, për dëmet që i janë kompensuar personave të tretë të dëmtuar. Nga shikimi dhe interpretimi i kësaj dispozite rrjedh se kërkon domosdoshmëri përgjegjësinë e shkaktuesit të dëmit apo personin përgjegjës.

Gjykata ka parasysh faktet jo kontestuese dhe atë se i padituri nuk ka pasur polisë valide të sigurimit, e po ashtu faktin se paditësja këtu BKS, ka ofruar prova të mjaftueshme që vërtetojnë se personit të tretë apo këmbësorit B.K.t, i është kompensuar shuma prej 837.00 euro. Megjithatë, gjykata rikujton se në mënyrë që të kompensohet dëmi duhet të jetë shkaktuar me fajin e personit, e që rrjedhimisht edhe obligimi për regres njëloj kërkon përgjegjësinë e personit.

Sipas ekspertizës së komunikacionit, të cilës gjykata ia ka falur besimin në tërësi ka rezultuar se aksidenti ka ndodhur me lëshimet e këmbësorit, kurse i padituri nuk ka pasur mundësi asesi ta shmang aksidentin. Për gjykatën, përfundimisht i padituri nuk mund të mbahet përgjegjës, e as të rimbursojë një dëm të cilin nuk e ka shkaktuar. Andaj, në këtë kontekst gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi si në dispozitivin nën pikën e dytë, ashtu që secila palë t'i bart shpenzimet e procedurës, konform nenit 450 të LPK-së, ngase përkundrejt se i padituri është palë fituese në këtë çështje kontestimore, megjithatë i njëjti nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Nga të cekurat në kuptim të nenit 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Dega në Kaçanik

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.188/2020 më datë 04.12.2024

Gjyqtare

---

Alba Makolli

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.